



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
 GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/  
 MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 37295/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Milivoje Stojanoviç nga fsh. Shillov K. Gjilan, për kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1.1 i Ligjit nr. 3/L -151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 15.11.2012 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI** :Milivoje Çedomir Stojanoviç , i lindur më 1969 ne Gjilan , ku dhe tani jeton ne fsh. Shillovë K. Gjilan Delegat në Kuvendin e Republikës se Kosovës, e gjendjes së mirë ekonomike.

**Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse i pandehuri në cilësinë zyrtarit te lartë publik, delegat në Kuvendin e Republikës se Kosovës, i cili është emëruar me dt. 05.07.2011 ku ka qen i obliguar me ligj që në afatin ligjor prej 60 dite, nga dita e marrjes se detyre ta deklaroj pasurin, në Agjencionit Kundër Korrupsionit, ku i njëjta nuk e ka deklaruar pasurin e vetë, të përcaktuar sipas keti ligji.

Me këtë ka kryer vepër kundërvajtës nga **7 paragrafi 1.1 i Ligjit nr. 3/L -151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë**, andaj për këtë:

**G J O B I T E T**

Me gjobë në shumë prej 300( treqind ) Euro, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merr formën e prerë, në dobi të AFQ i drejtësisë në Prishtinë, në gjirollogarin rrjedhëse 1000430070000518, nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke ia llogaritur nga 15 Euro në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumë prej 5 (pesë) Euro, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

Agjencia Kundër Korrupsionit , parashtrroi kërkesën nr. 01 4097 /11 të dt 24.10.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku dhe është marr Konkluzion Gjatë procedurës u dëgjua i pandehuri i cili në deklaratën e tij ku deklaroj se unë nuk kam qenë asnjëherë i informuar as përmes postes elektronike – imeles, as nga personeli gjegjësisht nga administrata e Kuvendit te Kosovës, ku unë qe nga data prej 05 deri 10 korrik e kam zavendsu Sasha Rashiq cili ka qenë delegat i Kuvendit, ku mua me kanë dergu partia ku jam anëtar, nuk kam ndonjë arsye përveç asaj qe e potencova se kjo ka qenë për shkak te mos informimit.

Për vërtetimin e gjendjes faktike u dëgjuar deklarata e parashtruesit te kërkesës Agron Behrami i cili në deklaratën e tij pohoj se sa i parkete kërkesë te cilën e kemi parashtrua ndaj deputetit Milovoje Stojanoviçit i cili nga pika kontaktuse kemi marr te dhënat se është emëruar deputet i Kuvendit te Kosovës me dt. 05.07.2011 dhe nga kjo kohë i njëjti nuk e ka deklaruar gjegjësisht huk e ka mbush formularin për deklarimin e pasurisë se zyrtarëve te lartë e përcaktuar me ligini nr. 03/L 151 i cili përcakton se në afatin prej 60 ditësh zyrtari i lartë ligjor duh ta plotësoj formularin por i njëjti nuk e ka mbush ketë formular, ku dhe kemi bë kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtës ndaj tij, kërkojë qe drejtë për se drejti te bëhtë ndryshimi i ligjit te aplikueshëm, ngase kërkesën e kemi bë në bazë ët Ligjit te ri, ku është ma i disfavorshme për palën, ndërsa ligjit i vjetër është ma i favorshme për palën dhe kërkoj qe kundërvajtja qe zgjidhet në bazë të Ligjit te vjetër, ku ndryshon vetëm sa i përket afati te paraqitjes se formularit si dhe sa i përket sanksionit. Ne si agjencion nga pikës kontaktues kemi pranuar te dhënat për zyrtarin ligjor ku i kemi dërguar formularin për deklarimin e pasurisë me cilën pikë kontaktues javë ka shpërnda neper postat e tyre ku shpërndahen edhe te gjitha materiale e punës se tyre, ku e njëjta mënyrë është vepruar edhe me deputet e tjerë qe i kanë mbush formularët, se na kemi pranuar ketë listë në ketë kohë dhe na ju kemi dhanë mundësi atyre qe te deklarojnë pasurin edhe pas keti afati ti dërgoj imell adresa, por deputeti konkret nuk e ka lajmëruar pasurin deri me dt. 24 tetor, pasi qe është fillu procedura.

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejt dhe të plotë vërtetoi gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

**GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE**

Fatmir Behrami

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund të ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksë.

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIKORUPCIJE  
 AGENCIJA ANTICORRUPTION AGENCY

03-4198/12

01

16.11.2012

PRISHTINE